



REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS

PRANUAR MË  
ACCEPTED ON  
PRIMLJENO

18/05/2023

01/701



Thirrje publike për ekspertë të jashtëm për Komisionin Vlerësues për Projektpropozime të OJQ-ve aplikuese në Thirrjen publike nr.prot.01/614, dt.24.04.2023

Komuna e Malishevës, gjatë vitit 2023, përmes Thirrjes Publike nr. 01/614, planifikon të ofrojë mbështetje financiare për OJQ-të kulturore, rinore dhe sportive, konkretisht mbështetjen e projekteve dhe programeve kulturore, rinore dhe sportive.

Rregullorja MF-Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafin 3.2 parasheh që pjesë e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve aplikuese në thirrjen publike

Thirrja Publike është për dy (2) anëtarë, prej tyre- një përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm dhe një përfaqësues nga OJQ.

Komuna e Malishevës i fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë në thirrjen publike për ekspertë të jashtëm, për të qenë pjesë e komisionit vlerësues për projektpropozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes Thirrjes Publike nr.01/614.

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët që janë:

- shtetas të Republikës së Kosovës
- të punësuarit apo anëtarët aktiv në OJQ që janë aktive në Republikën e Kosovës;
- ekspertë të pavarur, që kanë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- duhet të kenë diplomë universitare
- të kenë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve
- të mos jenë të emëruar politikë;
- të mos jenë shërbyes civil;
- të mos jenë punëtorë të Administratës Shtetërore;

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- një CV
- një letërmotivimi
- dëshmi për shkollimin;
- dëshmi për përvojën e punës
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër delegimi nga përfaqësuesi i autorizuar i OJQ-së në të cilën aplikuesi është anëtar apo i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: [dkrs\\_malisheva@hotmail.com](mailto:dkrs_malisheva@hotmail.com), nga data 18.05.2023 deri më 23.05.2023 dhe me anë të kopjes fizike, në Zyrën për pritjen e palëve në objektin e komunës.

Komisioni Vlerësues i caktuar nga Komuna e Malishevës, pasi të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve, do të formojë regjistrin e ekspertëve të jashtëm dhe të njoftohen të gjithë kandidatët e përzgjedhur.

Malishevë. 18.05.2023

